

LIGJ
Nr.7674, datë 23.2.1993

PËR SHËRBIMIN DHE INSPEKTORATIN VETERINAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shërbimi veterinar shqiptar është themeluar në vitin 1928 dhe është ligjëruar më 23.3.1929.

Neni 1

Ligji "Për shërbimin dhe inspektoratin veterinar" synon;

- a) Mbrojtjen dhe zhvillimin e faunës si pasuri kombëtare.
- b) Parambrojtjen, luftimin dhe zhdukjen e sëmundjeve ngjitëse, shtimin, rritjen e prodhimtarisë e përmirësimit të kafshëve bujqësore, shpendëve, zookulturave e kafshëve të egra, si dhe të prodhimeve të ujrave të kripura e të ëmbla.
- c) Ruajtjen e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet zoonoze që transmetohen nga kafshët e prodhimet e tyre, nga lëndët mbetëse në ushqimet e njerëzve e të kafshëve me mbajtje të dëmshme.
- ç) Mbrojtjen e mjedisit nga infeksionet, helmet, ndotjet dhe prishjet e ekosistemeve me pasoja dëmtoese për faunën shqiptare.

Neni 2

Shërbimi veterinar organizohet në sistem të centralizuar shtetëror në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u vendosur në sistemin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, në rreth, bashki, komunë dhe zona veterinare. Ai integron në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ministrisë së Rendit Publik, të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të Ministrisë së Tregtisë dhe të Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë, të Ministrisë së Arsimit etj.

Organet qendrore të administratës shtetërore veterinare janë Drejtoria e Veterinarisë dhe Këshilli i Lartë i Veterinarisë.

Neni 3

Shërbimi veterinar i Republikës së Shqipërisë është pjesë e pandarë e rrjetit veterinar ndërkombëtar e rajonal, me të cilin lidhet edhe me marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 4

Shërbimi veterinar funksionon si strukturë e dyfishtë, zbatimi e kontrolli, për të gjitha hallkat e veprimtarisë ekonomike, teknike e sociale, që lidhen me qëllimet për të cilat organizohet.

Neni 5

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit ngrihet Këshilli i Lartë i Veterinarisë, që miratohet

nga ministri dhe mbikëqyr gjithë veprimtaritë teknike e shkencore të shërbimit veterinar.

Rregullat e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Veterinarisë caktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 6

Inspektoriati veterinar organizohet brenda strukturës veterinare shtetërore si degë e veçantë. Ai vendoset në Drejtorinë e shërbimit veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, në rreth, bashki e komunë. Me detyrën e inspektorëve veterinarë veprojnë edhe veterinarët në strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 7

Në bashki funksionon zyra e shërbimit veterinar me inspektoriatin e shërbimit veterinar. Në strukturën e kësaj zyre futen edhe veterinerët e kontrollit të tregjeve, të thertoreve, frigoriferëve dhe të peshkut për eksport me këtë veprimtari.

Neni 8

Shërbimi veterinar në rrethe e komunë organizohet si sektor dhe zyrë e veçantë dhe varet nga ana administrative, teknike dhe financiare nga struktura organizative që përcaktohet në rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 9

Mjekët veterinarë, në të gjithë strukturën shtetërore veterinare deri në komunë, emërohen pasi të kenë fituar në testin profesional, kushtet e të cilit përcaktohen me rregullore nga Drejtoria e veterinarisë në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 10

Mjekët veterinarë kanë të drejtën e ushtrimit të profesionit privat, pasi ata të kenë marrë lejen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Ata detyrohen të plotësojnë këto kushte:

1. Të zbatojnë ligjin për shërbimin veterinar dhe të gjitha aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

2. Të njoftojnë mjekun veterinar shtetëror të bashkisë e të komunës për ushtrimin e profesionit si privatë të pavarur ose të punësuar në sektorin privat.

Mjekët veterinarë privatë mund të hapin klinika, laboratorë dhe farmaci me destinacion veterinar.

PJESA E DYTË

MASAT PËR RUAJTJEN E SHËNDETIT DHE RRITJEN E PRODHIMIT TË KAFSHËVE E TË SHPENDËVE BUJQËSORE TË EGRA

KREU I

SËMUNDJET QË I NËNSHTROHEN MASAVE SHËNDETËSORE VETERINARE

Neni 11

Mbahen nën kontroll veterinar dhe kërkojnë shpalljen dhe zbatimin e masave shëndetësore sëmundjet ngjitëse sipas grupeve të mëposhtme:

Grupi A

1. Aphta epizootike
2. Murtaja e gjedhëve (Pestis bovina)
3. Pleuropneumonia e gjedhëve (Pleuropneumonia contagioza bovina)
4. Murtaja klasike e derrave (Pestis porçine classique)
5. Murtaja afrikane e derrave (Peste porçine africaine)
6. Lija e dhenve-dhive (variola ovina-caprina)
7. Murtaja e shpendëve (Pestis avium)
8. Pseudopeste
9. Anemia infektive e kuajve

Grupi B

1. Plasja (Anthrax)
2. Këmbëzeza (gangrena empluzematosia)
3. Tërbimi (rabiese)
4. Leptoziproza
5. Ekinokokoza
6. Leukoza enzotike e gjedhëve
7. Paratifo e dhenve e dhive
8. Encefalomyeliti i kuajve
9. Riniti atrofik i derrave
10. Tifot e shpendëve
11. Mareku
12. Gumboro
13. Septicemia hemorragjike në gjedhë etj.
14. Tuberkulozi në kafshë e shpendë
15. Bruceloza
16. Agalakasia e dhenve e dhive
17. Fruthi i derrave
18. Varootoza e bletëve
19. Pestat e bletëve
20. Leshmanioza
21. Tularemia e lepujve
22. Enterotoksemia e dhenve e dhive

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, sipas propozimit të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar dhe me miratimin e Këshillit të Lartë të Veterinarisë, shton oe heq nga lista emërore e mësipërme sëmundje të tjera ngjitëse.

Neni 12

Në fjalën "kafshë", në kuptimin e këtij ligji, hyjnë të gjitha kafshët bujqësore (gjedhë, dhen, dhi, derra e njëthundrakë), duke përfshirë edhe shpendët, qentë, macet, lepujt, zogjtë, bletët, peshqit dhe krustacetë e molusqet, kafshët e egra që përbëjnë pasuri kombëtare.

Neni 13

Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit lëshon urdhra për çdo rast që ka të bëjë me mbajtjen në gjendje të mirë e prodhuesit të kafshëve, mbrojtjen e tyre nga sëmundjet ngjitëse, luftimin dhe zhdukjen e këtyre të fundit, si dhe me rregullimin e lëvizjes së kafshëve, të prodhimeve blegtorale, të lëndëve të para dhe të artikujve që mundësojnë faktorët mbajtës e përhapës të sëmundjeve ngjitëse.

KREU II LUFTIMI I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Neni 14

Pronarët privatë ose shtetërorë janë të detyruar të lajmërojnë menjëherë shërbimin veterinar më të afërt të zonës veterinare ose komunës e bashkisë në këto rajone në rastet e mëposhtme:

- a) Kur shfaqet ndonjë sëmundje ngjitëse e përmendur në nenin 11 të këtij ligji.
 - b) Kur shfaqet shenja me dyshime për qenien e ndonjë sëmundjeje ngjitëse.
 - c) Kur ka ngordhje të menjëhershme që krijojnë dyshime me shenja të infeksionit përkatës ose të sëmundjeve zoonoza.
- ç) Kur në kafshët e një oborri stalle ose stani, brenda 8 ditëve, shfaqen shenja të sëmundjeve të përsëritura në krerë të tjerë.

Pronari privat a shtetëror detyrohet që kafshët e dyshimta ose të sëmura t'i mbajë të veçuara dhe larg kafshëve të tjera, derisa të jepen udhëzimet nga shërbimi veterinar më i afërt.

Të njëjtat detyrime kanë edhe personat që zëvendësojnë pronarin e kafshëve ose drejtojnë kopetë e tij.

Drejtesi i pushtetit lokal detyrohet të lajmërojë menjëherë organet më të larta (komunën, bashkinë, rrethin) për njoftimin e bërë prej të interesuarve dhe këto të fundit detyrohen pa vonesë të vënë në dijeni veterinerin e shtetit të zonës përkatëse.

Neni 15

Detyrimi i lajmërimit shtrihet edhe për veterinerët privatë.

Lajmërimi duhet të bëhet me shkrim nga veterinerët privatë dhe u drejtohet veterinerëve të shtetit dhe të komunës, bashkisë e rretheve. Agjentët e sigurimeve shoqërore, gjuetarët dhe drejtuesit e pushtetit në fshatra janë të detyruar të lajmërojnë për çdo shfaqje infeksioni ose dyshim për sëmundjet ngjitëse, sikurse është i autorizuar të bëjë lajmërimin çdo shtetas.

Neni 16

Për lajmërimin e sëmundjeve ngjitëse të kafshëve gjatë lëvizjes me makina, anije, avion e tren zbatohen rregullat që do të caktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Kur kafshët udhëtojnë më këmbë, lajmërimi bëhet në zyrat e pushtetit lokal që ndodhen më afër vendit të shfaqjes së sëmundjes, të cilave u takon nga pikëpamja tokësore pranimi i këtyre lajmërimeve. Në lëvizjet e kafshëve me anije lajmërimi bëhet nga kapiteni i anijes dhe u drejtohet autoriteteve kompetente të skelës më të afërt. Këto të fundit njoftojnë menjëherë organin e pushtetit lokal në territorin ku janë vendosur.

Neni 17

Kur shfaqet ndonjë sëmundje ngjitëse në kafshë, shërbimi veterinar në rreth është i detyruar të njoftojë shërbimin veterinar në qendër e gjithë komunat e rrethit e ato fqinje, duke u bërë të pranishëm vendin e infeksionit dhe masat e shërbimit veterinar të vëna në zbatim për luftimin e sëmundjes.

Gjithashtu, detyrohet të njoftojë pa vonesë rrethet kufitare, inspektorët dhe veterinerët e shtetit që shërbejnë në to. Po këtë detyrim e kanë edhe inspektorët veterinerë, të cilët duhet të lajmërojnë rregullisht autoritetet shtetërore nga varen.

Këshilli i rrethit, bashkisë dhe komunës detyrohet ta shpallë njoftimin veteriner pa vonesë në gjithë juridiksionin e tij, duke njoftuar veçanërisht pronarët që merren me rritjen e përqëndruar të kafshëve.

Neni 18

Quhen të sëmura kafshët, te të cilat vërtetohen shenjat e një sëmundje infektive, ose ato kafshë që kanë qenë drejtpërdrejt a tërthorazi në kontakt me kafshë të sëmura, me kusht që në këto të jenë shfaqur shenja të dukshme e bindëse të një sëmundjeje ngjitëse.

Gjithashtu, do të quhen të dyshimta për sëmundje ngjitëse kafshët që vuajnë nga sëmundje të brendshme, nëse brenda 8 ditëve shfaqet ndonjë rast tjetër me shenja të njëjta ose të përngjashme.

Neni 19

Vërtetimi dhe luftimi i sëmundjeve të kafshëve që i përkasin Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Rendit Publik bëhet nga shërbimi veterinar dhe autoritetet ushtarake. Këto autoritete detyrohen të venë në dijeni, në çdo rast dyshimi ose shfaqjeje të një sëmundjeje ngjitëse, zyrat veterinare më të afërta, të cilat marrin masat e parashikuara prej këtij ligji për të penguar përhapjen e sëmundjeve në kafshë që nuk janë pronë ushtarake.

Neni 20

Nëse në kafshët shfaqen sëmundje që infektojnë edhe njerëzit (zoonozat), veterineri i shtetit është i detyruar të vërë në dijeni menjëherë mjekun human të zonës dhe drejtorinë e shëndetit publik.

Mjekët dhe drejtoria e shëndetit publik detyrohen të njoftojnë zyrat veterinare përkatëse për shfaqjen në njerëz të çdo sëmundjeje ngjitëse të ardhur nga kafshët.

Veterinerët e shtetit bashkëpunojnë me institucionet higjieniko-shëndetësore për luftimin dhe zhdukjen e sëmundjeve ngjitëse. Ky detyrim vlen edhe për institucionet higjieniko-shëndetësore, kur u është drejtuar kërkesë nga veterinerët e shtetit.

Neni 21

Për forcimin e kontrollit dhe të bashkëpunimit ndërministror për organizimin e masave kundër sëmundjeve ngjitëse zoonoza, në Ministrinë e Shëndetësisë e të Mbrojtjes së Mjedisit dhe në qendrat higjieniko-shëndetësore në rrethe ngrihen zyra shëndetësore veterinare me vartësi teknike nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Drejtoria e Shërbimit Veterinar ose shërbimi veterinar i rrethit.

Neni 22

Kryetarët e bashkive e të komunave kanë detyrë të urdhërojnë për:

- a) Izolimin në vend të kafshëve të sëmura a të dyshimta.
- b) Ndalimin e lëvizjes së kafshëve.
- c) Mbajtjen të veçuara në vende të posaçme të kafshëve të therura ose të ngordhura, deri në ardhjen e veterinerit të shtetit.
- ç) Veçimin në mënyrë të sigurt të të gjitha kafshëve të shëndosha nga të sëmurat ose të dyshimtat, duke i ndarë ato në vende të përshtatshme.
- d) Ndalimin e tregjeve të kafshëve.

KREU III

MASA TË PËRBASHKËTA PËR TË GJITHA SËMUNDJET NGJITËSE DHE ÇERTEFIKATAT VETERINARE

Neni 23

Çertifikata veterinare është dëshmi, nëpërmjet së cilës vërtetohen lloji, pronësia, origjina, raca, mosha dhe gjendja shëndetësore e kafshëve. Ajo lëshohet për çdo kafshë të trashë ose për grupe, kur janë bagëti të imta, shpendë, peshq, zookultura e prodhime mishi, si dhe produkte me origjinë shtazore që përdoren për ushqimin e njerëzve, për industrializim, për ushqime për kafshë, për biopreparate e medikamente ose produkte biologjike veterinare.

Çertifikata lëshohet me kërkesë të pronarit për qëllime të ndryshme, që specifikohen në të.

Neni 24

Procedura për dhënie çertifikatave veterinare dhe të formularëve të tyre përcaktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 25

Kafshët e trasha me vlera të veçanta ekonomike e racore pajisen me pasaporta individuale, në të cilat regjistrohen të gjitha masat e profilaksisë që u janë kryer. Gjatë lëvizjes nuk ka nevojë që ato të shoqërohen me certifikatë veterinare. Këto kafshë janë të regjistruara në librat shtetërorë.

Neni 26

Kafshët që vuajnë nga sëmundje ngjitëse, për të cilat lajmërimi është i detyrueshëm, ose për të cilat dyshohet t'i kenë ato sëmundje, ndalohet të dalin nga ekonomia ose familja pronare, me përjashtim të rasteve kur mjeku veterinar shtetëror i komunës, bashkisë ose rrethit urdhëron me shkrim.

Neni 27

Veterineri i shtetit, me të marrë njoftimin për shfaqjen ose dyshimin për një sëmundje ngjitëse, është i detyruar të shkojë menjëherë në vend për kontroll zyrtar, gjatë të cilit duhet të studiohen rrethanat dhe shkaku i shfaqjes, si dhe të urdhërohet marrja e masave të parashikuara në këtë ligj për kufizimin, luftimin dhe zhdukjen sa më parë të sëmundjes ngjitëse. Në rast se veterineri i shtetit, për kontrollin që do të kryejë, ka nevojë për praninë e një nëpunësi të administratës së pushtetit lokal, pjesëmarrja e këtij të fundit është e detyrueshme. Kur shfaqet gjendje epizootike e veçantë, shtetasit janë të detyruar të zbatojnë urdhërat e veterinerit.

Neni 28

Nëse gjatë kontrollit vërtetohet sëmundje ngjitëse, merren menjëherë masat e nevojshme për parambrojtjen. Kontrolli veterinar duhet të përsëritet brenda afateve të nevojshme. Në rast se, sipas mendimit të veterinerit të shtetit, për të vërtetuar qenien e një sëmundjeje ngjitëse, del e nevojshme të theren një ose disa kafshë të dyshimta, ai ka kompetencë ta bëjë një gjë të tillë, me kusht që më parë të kryhen formalitetet përkatëse për caktimin e çmimit të tyre. Organet e brendshme të kafshëve, ose materiale të tjera nga kafshë të ngordhura, të therura a të gjalla, i dërgohen laboratorit veterinar të rrethit për vërtetim të sëmundjes për të cilën dyshohet.

Neni 29

Mjeku veterinar ka kompetencë të kontrollojë, mjekojë, vaksinojë, regjistrojë dhe veçojë kafshët e sëmura ose që dyshohen për të tilla, si dhe të atyre kafshëve që mund të bëhen shkaktare të sëmundjeve ngjitëse.

Ndalon lëvizjen, kullotjen, therjen, tregjet dhe ekspozitat si dhe kryen veçimin e kafshëve të sëmura nga të dyshimtat.

Gjithashtu urdhëron asgjesimin e menjëhershëm të trupave të ngordhur ose të therur dhe të pajisjeve të tyre, të ushqimit, mbeturinave etj., si edhe kryerjen e dezinfektimeve sipas rregulloreve përkatëse.

Neni 30

Mjeku veterinar detyrohet që, gjatë kohës që vazhdon infeksionimi në kafshë, të ndjekë vatrën e infeksionit deri në zhdukjen e saj, për të bërë kontrollin e kafshëve, për të përcaktuar detyrat konkrete dhe të ndjekë zbatimin e tyre.

Neni 31

Për sëmundje dhe përhapje të shpejtë ose me karakter enzotik dhe epizootik me pasoja ekonomike të rënda miratohen projekte shtetërore izolimi dhe çrrënjosjeje.

Neni 32

Autoritetet shtetërore janë përgjegjës për zbatimin e përpiktë të masave në rajonin e tyre. Ato kanë për detyrë të mbikëqyrin zbatimin e plotë të këtyre masave.

Neni 33

Pronarët detyrohen të mjekojnë e vaksinojnë kafshët e tyre të infektuara, kur këto gjykohen të domosdoshme. Kafshët e infektuara ose të dyshimta mjekohen vetëm nga veterinerët e përcaktuar në këtë ligj.

Neni 34

Organet e pushtetit lokal, specialistët e veterinarisë, personat fizikë e juridikë që mbajnë kafshë, shpendë e zookultura, si dhe ata që merren me tregtimin e përpunimin e produkteve blegtorale dhe të ushqimeve për blegtorinë, për parandalimin, kufizimin e luftimin e sëmundjeve tepër përhapëse (të grupit A dhe B), janë të detyruar të kërkojnë dhe zbatojnë dispozitat e këtij ligji si dhe rregulloret që do të nxjerrë Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për këtë qëllim.

KREU IV

TRAJTIMI I SËMUNDJEVE NGJITËSE TË GRUPIT A DHE I SËMUNDJEVE TË PËRBASHKËTA TË GRUPIT B

Aphta epizootike

Neni 35

Pas shfaqjes së sëmundjes të aphtës epizootike të urdhërohet therja e kafshëve të sëmura dhe të dyshimta.

Komisioni për luftimin e sëmundjes ose veterineri i autorizuar ka të drejtë të propozojë therjen dhe kushtet në të cilat do të kryhet. Nëse sëmundja në fjalë përhapet me shpejtësi, veterinerët kanë të drejtë të kërkojnë ndalimin e qarkullimit të kafshëve në zonat e tjera. Kryetari i komunës, bashkisë e rrethit është i detyruar të respektojë kërkesën e veterinerit të shtetit.

Ndalohet shitja, përdorimi dhe industrializimi i mishit e qumështit të pazier gjatë gjithë kohës së infeksionit ose rrezikut të tij.

Lejen për therjen e kafshëve të sëmura për konsum e jep vetëm veterineri i shtetit.

Vaksinimi i kafshëve brenda një territori gjatë një periudhe të caktuar bëhet i detyrueshëm me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, ku përcaktohet edhe tipi i vaksinës.

Murtaja e gjedhëve

Neni 36

Gjatë kohës që ekziston rreziku i hyrjes nga një shtet fqinj i murtajës së gjedhëve në krahinat e kufirit tonë, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit merr çdo masë për pengimin e përhapjes së infeksionit. Është e ndaluar therja e gjedhëve të sëmura për konsum publik. Shërbimi veterinar merr masa për vendosjen dhe zbatimin e të gjitha rregullave karantinore.

Pleuropneumonia e gjedhëve

Neni 37

Nëse vërtetohet shfaqja e një sëmundjeje ose dyshohet për të, vendi a zona vihen në karantinë dhe gjedhët e sëmurë ose të dyshimtë theren menjëherë.

Gjatë kohës, kur ekziston rreziku i hyrjes së infeksionit të një sëmundjeje, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit urdhëron dhe cakton detyra të veçanta për kufizimin dhe luftimin e kësaj sëmundjeje.

Murtaja klasike dhe afrikane e derrave

Neni 38

Sëmundja zhduket me therjen e derrave të kultivuar dhe vrasjen e derrave të egër në territoret e infektuara që vuajnë ose për të cilët dyshohet; për therjen dhe vrasjen e tyre ka të drejtë të urdhërojë Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Drejtoria e Shërbimit Veterinar urdhëron vaksinimin e derrave për zonat që janë në rrezik të infektohen e që mund të bëhen faktorë për përhapjen e sëmundjes.

Prodhimet e dala nga therja ose vrasja e derrave autorizohen për konsum pas zierjes e autoklavizimit, ose pas kalimit në mjete të tjera që shkatërrojnë agjentin viral, në të kundërtën konfiskohen.

Lija e dhenve e dhive

Neni 39

Kur shfaqet lija e dhenve e dhive, autoritetet veterinarë janë të autorizuar të urdhërojnë vaksinimin e të gjitha kafshëve që janë të shëndosha. Tufat e prekura asgjësohen dhe vendoset karantina. Qumshti i prodhuar prej tyre nuk përdoret.

Murtaja e shpendëve

Neni 40

Nëse në një krahinë shfaqet murtaja e shpendëve, autoritetet veterinarë kanë të drejtë të urdhërojnë therjen e shpendëve të sëmurë ose të dyshimtë dhe menjëherë merren masa parambrojtëse në shpendët që kërcënohen nga rreziku.

Pseudopesti

Neni 41

Nëse në një territor, stallë apo familje vërehet pseudopesti, autoritetet veterinarë urdhërojnë therjen e shpendëve të sëmurë dhe kryerjen e vaksinimit si dhe marrjen e masave parambrojtëse në shpendët që kërcënohen nga rreziku.

Pronarët e pulave për vezë dhe broilerëve detyrohen të kryejnë vaksinimin dy herë në vit të gjithë krerëve në pronësi, edhe kur tufat e tyre janë të paprekura nga kjo sëmundje.

Anemia infektive e kuajve

Neni 42

Në rast dyshimi ose shfaqjeje të anemisë infektive të kuajve merren masa për izolimin e tufave të prekura dhe shpalljen e zonave të karantinës.

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit urdhëron dhe përcakton masa të posaçme për kufizimin dhe luftimin e kësaj sëmundjeje.

Anthrax (plasja)

Neni 43

Ndalohet therja, manipulimi dhe shitja ose përdorimi për ushqim të njerëzve i mishit, qumështit dhe produkteve të tij nga kafshë të sëmura, ose për të cilat dyshohet se kanë sëmundjen e plasjes. Mjekimi bëhet vetëm nga veterinerët e shtetit ose nën mbikëqyrjen e tyre.

Ndalohet rrjepja e kafshëve të ngordhura, ose që pas therjes vërtetohet se kanë qenë prekur prej plasjes. Kafsha, bashkë me mjetet e tjera të ardhura në kontakt me të, digjet ose groposet thellë. Të gjithë shtetasit që kanë gjedhë dhe bagëti të imta, detyrohen t'i vaksinonjë ato çdo vit.

Tërbimi

Neni 44

Në rastet e shfaqjes së tërbimit, ose të paraqitjes së shenjave të dyshimta të kësaj sëmundjeje, pronarët detyrohen t'i vrasin ose t'i veçojnë kafshët me urdhër të veterinerit, në mënyrë që të largohet rreziku i përhapjes së sëmundjes në kafshë e në njerëz; ndalohet therja e tyre.

Qentë dhe macet, për të cilat dyshohet se janë tërbuar, si dhe ato që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me to, vriten.

Nëse qentë apo macet kafshojnë njerëz pa shkak, duhet të mbyllen në vende të sigurta dhe të vihen nën mbikëqyrjen e veterinerit të bashkisë ose të zonës së komunës.

Kafshët shtëpiake, përveç qenit dhe maces, për të cilat dyshohet se janë kafshuar nga kafshë të tërbuara a që kanë rënë në kontakt me to, veçohen dhe mbahen nën kontrollin veterinar, në qoftë se pronari nuk pretendon të vriten. Ky kontroll do të zgjasë së paku gjashtë muaj për kuajt e gjedhët dhe tre muaj për derrat, dhentë e dhitë. Shpenzimet e kryera paguhet nga pronari. Nëse kafshët e dyshimta si të tërbuara vihen në karantinë, duhet të mjekohen vetëm nga veterineri i shtetit. Kur autoritetet informohen se qentë e tërbuar ose që dyshohen si të tillë, qarkullojnë, kryetari i bashkisë ose i komunës urdhëron menjëherë organet e policisë dhe komunalen që të kapen a të vriten.

Në zonat e shpallura me tërbim, pronarët e qenve detyrohen të kryejnë vaksinimin e tyre sipas udhëzimeve të shërbimit veterinar.

Në qytete ndalohet lëvizja e qenve të pashoqëruar nga pronarët. Në të kundërtën ata kapen dhe eliminohen nga organet e bashkisë.

Kufomat e kafshëve të ngordhura nga tërbimi groposen me gjithë lëkurë ose digjen. Kur dihet data e saktë e kafshimit të kafshës, lejohet therja e saj brenda 5 ditëve nga dita e kafshimit, si dhe konsumi i mishit.

Neni 45

Në qoftë se tërbimi është përhapur në shkallë të gjerë ndër qentë e macet e rajonit të një bashkie ose komune ose, po të jetë se shfaqen raste të ripërsëritjes së tërbimit, autoritetet veterinare kanë të drejtë të kërkojnë që të vriten të gjithë qentë e macet e juridiksionit të asaj bashkie ose komune. Kërkesa në fjalë vihet në zbatim nga autoritetet administrative përkatëse.

Bruceloza

Neni 46

Pronarët e kafshëve që dështojnë, janë të detyruar të njoftojnë veterinerin e zonës dhe të zbatojnë masat e rekomanduara.

Në rastet e diagnostikimit të brucelozës gjedhët dhe kafshët e imta theren menjëherë. Tufa vendoset në izolim dhe i nënshtrohet masave të përcaktuara në rregulloren e nxjerrë nga Minsitria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Në zonat ku ka infeksion brucelor, pronarët e kafshëve detyrohen të lejojnë kryerjen e gjurmimeve të përvitshme.

Neni 47

Mjeku veterinar dhe laborator veterinar diagnostik njoftojnë Drejtorinë e Shëndetit Publik të territorit përkatës për vatrën e brucelozës dhe së bashku marrin masa veterinare e sanitare për mënjanimin e saj.

Neni 48

Vaksinimi kryhet vetëm për tufa me gjedhë, dhen e dhi, për të cilat shëndetësimi nuk arrihet dot me therje.

Neni 49

Për zonat e rënduara nga infeksioni në gjedhë, kryetari i këshillit të rrethit shpall karantinë, sipas propozimit të shërbimit veterinar.

Tuberkulozi

Neni 50

Çdo pronar që mbarështon gjedhë, detyrohet të kryejë çdo vit kontrollin alergjik për TBC. Në rast se sëmundja shfaqet në formë sporadike, kafshët pozitive theren. Në rastet enzotike tufat i nënshtrohen masave izoluese dhe të shërbimit sipas rregullores së nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 51

Në rastet e tuberkulozit në kafshë të tjera dhe në shpendë, masat janë po ato të nenit 50 të këtij ligji.

Agalaksia ngjitëse

Neni 52

Kur ka shfaqje klinike të agalaksisë ngjitëse në dhen e dhi, pronari detyrohet të bëjë vaksinimin e përvitshëm.

Qumështi i krerëve të sëmurë nuk lejohet të përdoret për konsum të freskët për popullsinë. Veterineri i shtetit përcakton zonat e infeksionit dhe masat për luftimin e tij.

Paratifoja e të imtave

Neni 53

Në rast se në tufat e bagëtive të imta diagnostikohet paratifoja, pronari detyrohet të kryejë çdo vit vaksinimin e kafshëve pjellëse.

Leukoza enzotike e gjedhëve

Neni 54

Të gjithë pronarët e gjedhëve detyrohen të kontrollojnë serologjikisht një herë në vit krerët me moshë mbi 6 muajsh për leukozën enzotike të gjedhëve.

Krerët që dalin pozitivë, ndalohet të shiten. Ato veçohen dhe u caktohet afati i skartimit nga veterineri i zonës. Pronari detyrohet të zbatojë afatin e skartimit dhe zbatimin e masave të tjera sanitaro-veterinare deri në shpalljen e ekonomisë së pastër nga infeksioni.

B. Sëmundje të tjera të detyruara për deklaram dhe masa të veçanta

Neni 55

Pronarët e kafshëve janë të detyruar të deklarojnë praninë e sëmundjeve të mëposhtme:

- septicemija hemorragjike e gjedhëve
- këmbëzeza
- dështimi enzotik i dhenve
- leptospiroza
- enterotoksemija
- IBR dhe BDV
- ethja katarale e gjedhëve, dhenve e dhive
- anaplazmoza, babezioza, ekinokokoza
- stomatiti vezikular i gjedhëve
- fruthi i derrave
- riniti atrofik i derrave
- sëmundja vezikulare e derrave
- aujesku
- meningo-ancefalitet virale të njëthundrakëve
- tifo, marek qumboro, pasterelozë, salmonelozë të shpendëve
- varoatozë, pestat, acariazis në bletë
- tularemi, sëmundja virale hemorragjike e lepujve
- leshmanioza, lija, parvavioza në qen
- listeriozë

Pas diagnostikimit për sëmundjet e mësipërme zbatohet mjekimi dhe masa të tjera veterinare, të detyruara sipas rregullores së Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Prodhimet e rrjedhura nga kafshët, shpendët dhe zookulturat e mësipërme të sëmura trajtohen sipas rregullores së veçantë të kontrollit të mishit, peshkut dhe produkteve të tjera.

Në të gjitha rastet veterineri i shtetit që ka në zonën e tij rastet e sëmundjeve të mësipërme, detyrohet të zbatojë, kontrollojë dhe urdhërojë vaksinimin, mjekimin dhe marrjen e masave të tjera për kufizimin dhe shëndetësimin e vatrës.

KREU V DËMSPËRBLIMI DHE NDIHMAT E SHTETIT PËR KAFSHËT QË DALIN TË PREKURA NGA SËMUNDJET NGJITËSE

Neni 56

Pas ripërtypësit, njëthundrakët dhe derrat që në këtë ligj parashikohen me vrasje, therje e groposje, në mbështetje të vendimeve të marra nga autoritetet kompetente, ose për të cilët vërtetohet se kanë ngordhur pas vaksinimit të urdhëruar nga autoritetet e pushtetit lokal përkatës, do t'i jepet dëmshpërblimi nga fondi shtetëror pronarit të kafshës së vvarë ose të ngordhur në masën e vlerës së plotë të kafshës për sëmundjet e grupit A dhe 75 për qind të grupit B, përveç rasteve të specifikuara me akte nënligjore.

Neni 57

Komisioni për caktimin e çmimit të kafshëve përbëhet nga veterineri, zootekniku i pushtetit lokal dhe nga një anëtar i këshillit të bashkisë ose komunës. Komisioni kryesohet nga veterineri.

Neni 58

Për ripërtypësit, njëthundrakët, derrat dhe shpendët shtëpiakë që therren me urdhër të shërbimit veterinar dhe për të cilët pas autopsisë vërtetohet se ishin të shëndoshë ose të konsumueshëm me kusht, do të paguhet si dëmshpërblim vlera reale e tyre, duke zbritur vlerën e përcaktuar nga konsumi.

Neni 59

Për rastet e sëmundjeve të grupit A përjashtohen sëmundjet e shpendëve; dëmshpërblimi caktohet nga komisioni i pushtetit lokal.

Neni 60

Në gjedhët me tuberkuloz vlera e dëmshpërblimit të kafshëve të therura do të jetë e plotë, pa marrë parasysh përfitimin nga vlera e sasisë që do të lejohet për përdorim. Dëmshpërblimi do të paguhet duke marrë për bazë çmimin e caktuar para therjes.

Neni 61

Nuk do t'i jepen shpërblime pronarit të kafshëve ose personave të tjerë në këto raste:

- a) Nëse pronari ose i autorizuari i tij nuk bën lajmërimin për shfaqjen e infeksionit.
- b) Në rast se pronari është vetë fajtor për shfaqjen e infeksionit, duke blerë kafshë të sëmura ose të dyshimta pa çertifikatë veterinare.
- c) Kur pronari nuk e ka zbatuar këtë ligj dhe rregulloret veterinare për gjurmimet ose vaksinimet preventive të kafshëve.

Neni 62

Shpenzimet që kryhen për zbatimin e masave veterinare për mbrojtjen e territoreve të gjera nga sëmundjet e grupit A që kalojnë caqet e një ekonomie familjare brenda juridiksionit të bashkisë ose të komunës, janë në ngarkim të bashkive ose komunave, si dhe për mënjanimin e kërmave, për mjetet e dezinfektimit dhe për sigurimin e masave të tjera të domosdoshme.

Gjithashtu shpenzimet ngarkohen edhe për personat që nevojiten të ndihmojnë për vaksinimet, dezinfektimet dhe shërbimet të tjera.

Neni 63

Shpenzimet që sipas këtij ligji kryhen në territore të gjera që kalojnë kufijtë e një komune apo bashkie janë në ngarkim të buxhetit të shtetit dhe përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 64

Vaksinimet dhe gjurmimet e detyruara në ligj bëhen falas. Shpenzimet e prodhimit, vaksinave dhe diagnostikimeve i buxhetohen Institutit të Kërkimeve Veterinare nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, sipas skemave të zbatimit që përcakton me projekte të veçanta për çdo sëmundje.

PJESA E TRETË

MBROJTJA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MGA HYRJA E DALJA E SËMUNDJEVE NGJITËSE TË KAFSHËVE

QARKULLIMI DHE TRANSPORTI I KAFSHËVE DHE I PRODHIMEVE E NËNPRODUKTEVE TË TYRE TË PËRPUNUARA OSE JO BRENDA DHE JASHTË VENDIT

Neni 65

Për mbrojtjen e territorit të Republikës së Shqipërisë nga hyrja e sëmundjeve dëmtuese të kafshëve nga shtetet e tjera, si dhe për të penguar daljen e këtyre sëmundjeve për në vende të tjera, vendoset kontrolli veterinar kufitar.

Neni 66

Importimi, eksportimi dhe kalimi tranzit i kafshëve, shpendëve, mishit, peshkut, kafshëve të vrara ose të kapura në gjueti, zookulturave, prodhimeve me prejardhje shtazore, ushqimeve për kafshë, produkteve biologjike, medikamenteve dhe biopreparateve nëpër kufijtë shtetëror (tokë, det, ajër) të Republikës së Shqipërisë lejohen vetëm nëpërmjet qendrave kufitare të kontrollit veterinar, të caktuara nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 67

Kur në vendet e huaja janë shfaqur sëmundje të kafshëve me karakter përhapës, Drejtoria e Veterinarisë, me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit ka të drejtë të kufizojë qendrat kufitare të kontrollit shëndetësor veterinar dhe të ndalojë, për sa kohë do ta shohë të arsyeshme, importimin dhe kalimin tranzit të kafshëve, shpendëve, mishit, prodhimeve me prejardhje shtazore, si dhe sendeve të tjera që mund të jenë bartës të këtyre infeksioneve.

Neni 68

Veterineri i qendrës kufitare lejon kalimin e ngarkesës vetëm pasi e kontrollon atë, e gjen të rregullt, të pajisur me çertifikatë tip ndërkombëtar të firmosur nga zëvendëskryetari i rrethit nisës, si dhe me licencën e Drejtorisë së shërbimit veterinar të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit. Në zbatimin e masave veterinare shëndetësore në kufi marrin pjesë edhe organet e policisë kufitare, repartet e mbrojtjes kufitare dhe autoritetet e doganave, të cilat nuk kryejnë veprimet për hyrjet, daljet ose tranzitimin në territorin e Republikës të materialeve të përcaktuara në nenin 66, pa i kontrolluar më parë nga veterineri i qendrës kufitare.

Ushqimet me origjinë nga kafshë që marrin me vete shtetasit, shoferët ose persona të tjerë, lejohet pasi të jenë kontrolluar në vend nga veterinerët e qendrës kufitare dhe të gjenden të rregullta.

Neni 69

Veterineri i qendrës kufitare të kontrollit veterinar varet nga kryeveterineri i rrethit dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Ai merr kontakte pune me palën veterinare të shtetit tjetër kufitar dhe për këtë raporton në organet më të larta.

Neni 70

Në qendrat e kalimit kufitar kanë përparësi për kontrollim, në krahasim me mallrat e tjera, kafshët, shpendët e peshqit e gjallë si dhe gjallesat e tjera që përmban ky ligj.

Neni 71

Veterineri i qendrës së kontrollit shëndetësor veterinar kufitar bashkëpunon me organet e mbrojtjes së kufirit, me punonjësit e doganës, me agjencitë rrugore, detare, ajrore dhe hekurudhore si dhe me shërbimin shëndetësor të karantinës, për problemet që lidhen me të. Ai bën pjesë në grupin e praktikës që merr kontaktin e parë me mjetet dhe mallrat që lëvizin në kufi.

Neni 72

Masat për pengimin, diagnostikimin, kthimin e ngarkesës ose groposjen, therjen, utilizimin e saj etj., merren nga veterineri i qendrës kufitare, i cili ve në dijeni kryeveterinerin e rrethit nga varet dhe Drejtorinë e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit. Për këtë veprim vihet në dijeni edhe pala eksportuese, importuese ose që tranziton ngarkesat.

Shpenzimet që kryhen për këto veprime i ngarkohen palës në përputhje me konventat, marrëveshjet shtetërore e kontratat, ose pronarit që e ka këtë mall. Në rast refuzimi të likuidimit të

shpenzimeve, çështja zgjidhet në gjyktën e rrethit që përfshin territorin e kalimit kufitar përkatës.

Neni 73

Qendra kufitare veterinare vendoset në mjedise që plotësojnë kushtet teknike për izolimin dhe zhdukjen e materialeve të infektuara. Fondet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së tij mbulohen nga buxheti i rrethit.

Neni 74

Eksportimi, importimi dhe kalimi tranzit i materialeve të përcaktuara në këtë ligj bëhet me tarifë veterinare të nxjerrë nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Financave dhe e Ekonomisë; të ardhurat derdhen në buxhetin e rrethit që mbulon pikën veterinare kufitare.

PJESA E KATËRT KREU I KONTROLLI VETERINAR I TREGJEVE DHE TRAFIKUT

Neni 75

Tregtimi i kafshëve bëhet në tregje të caktuara në territore që janë larg qendrave të banuara dhe rrugëve kryesore. Ato janë pronë e bashkisë ose e komunës. Vendimi për çeljen, mbylljen, lëvizjen e vendvendosjen dhe organizimin e brendshëm nxirret nga kryetari i bashkisë ose i komunës, mbasi të merret miratimi i inspektoratit veterinar dhe sanitar.

Neni 76

Tregjet e shitjes së mishit dhe bulmetit janë të ndara nga njëri-tjetri dhe vendosen brenda territorit të qendrës së banuar, në mjedise të përshtatshme higjieniko-shëndetësore veterinare.

Vendvendosjet dhe organizimi bëhen nga bashkia ose komuna. Ato janë pronë e bashkisë ose e komunës dhe administrohen prej tyre.

Kompetencat e ndërsjellta sanitaro-veterinare dhe sanitaro-shëndetësore përcaktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 77

Therja e kafshëve bëhet:

- në qytete vetëm në thertoren e miratuar nga bashkia dhe inspektorati veterinar e sanitar.
- në komuna vetëm në pika therjeje të caktuara nga zyra veterinare dhe të miratuara nga komuna dhe inspektorati sanitar.

Në të gjitha rastet bëhet regjistrimi i kafshëve të therura.

Ndalohet tregtimi i mishit jashtë tregjeve të përcaktuara si dhe i mishit të kafshëve të therura jashtë thertoreshes ose pikave të therjes.

Neni 78

Deri në tregjet e qyteteve dhe qendrat e tjera të banuara lejohet tregtimi i mishit, i qumështit, i peshkut dhe nënprodukteve të tyre, si dhe i ushqimeve për blegtorinë, vetëm pas kontrollit nga shërbimi veterinar, i caktuar për këtë qëllim në strukturën shtetërore të pushtetit lokal, si dhe nga laboratorë veterinarë të specializuar për infeksione e mbetje të lëndëve të dëmshme për shëndetin e konsumatorëve. Ato të jenë të shoqëruara me certifikatat veterinare përkatëse të vulosura sipas kritereve të përcaktuara me rregullore të veçantë të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 79

Veterineri i shtetit dhe inspektorati sanitar kontrollojnë kushtet higjieniko-shëndetësore e veterinare në thertoret, pikat e therjes, kombinatet e mishit, frigoriferët, qendrat e përpunimit të

produkteve e nënprodukteve blegtorale dhe të tregtimit të tyre, si dhe japin leje për ngritjen e tyre. Gjithashtu ata kanë kompetencë të pezullojnë ose ta mbyllin këtë veprimtari.

Neni 80

Ushqimet që përdoren për kafshë, si ato të thjeshta me origjinë bimore e shtazore ose të përbëra me plotësuesit me efekte stimuluese ose stimuluese të vendit a të importuara, lejohet të tregtohen e përdoren pasi të jenë të shoqëruara me çertifikatën sanitaro-veterinare, ku përfshihen edhe analizat laboratorike veterinare që përcaktohen sipas standardeve të miratuara nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar, të kontrolluara metodikisht nga Instituti i Kërkimeve Veterinare dhe të depozituara në organet qendrore të standardeve.

Neni 81

Personat fizikë e juridikë që duan të prodhojnë ushqime të përpunuara për blegtorinë me qëllim shitjeje, pajisen me autorizim nga organet përkatëse të rrethit, e vërtetuar kjo paraprakisht nga një komision i përbërë nga kryeveterineri i rrethit, kryezootekniku, kryeagronomi dhe një anëtar i seksionit të tregtisë. Mbas pajisjes me këto dokumente lëshohet licenca nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit.

Neni 82

Transportimi i kafshëve dhe i produkteve e nënprodukteve blegtorale bëhet kur mjeti transportues është i përshtatshëm, i është nënshtruar më parë masave të pastrimit e dezinfektimit dhe ka kushte që gjatë transportit të ruhet pastërtia. Lëndët dhe mënyrat e dezinfektimit të mjeteve të transportit caktohen me rregullore të veçantë që nxjerr Drejtoria e Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

KREU II

MBROJTJA E MJEDISIT NGA INFEKSIONET, HELMET DHE NDOTJET NGA KAFSHËT

Neni 83

Në rastet e ndotjes së mjedisit me shkaktarë infektivë nga kafshët e sëmura, të ngordhura, therura dhe produktet e tyre, veterineri i shtetit urdhëron pronarin për marrjen e masave higjieniko-shëndetësore dhe kontrollon zbatimin e tyre. Ai ka të drejtë të ndalojë lëvizjet, kullotjen, strehimin, ndërtimet dhe ekspozitat blegtorale në mjedise të tilla.

Neni 84

Veterineri i pushtetit lokal ka për detyrë të ndalojë përdorimin e lëndëve kimike bujqësore e jobujqësore, kur ato ndotin mjedisin ku kafshët strehohen, kalojnë, kullotin ose tregtohen, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Neni 85

Veterineri i komunës jep lejen e përdorimit të lëndëve kimike bujqësore në territore ku ujrat rrjedhin në rezervuarë, lera ose vendmbledhje ujërash që përdoren për bagëtitë dhe kafshët e egra, ose kur kultivohen peshq, kafshë të ujit etj.

Neni 86

Në rast të ndotjes së mjedisit nga mbetje të industrisë përpunuese dhe asaj ushqimore me pasoja për blegtorinë, drejtuesit e pushtetit lokal kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim për pasojat e

dëmtimit të shkaktuar pronarëve të kafshëve.

KREU III BIOPREPARATET, MEDIKAMENTET DHE PRODHIME BIOLOGJIKE PËR KAFSHË

Neni 87

Biopreparatet janë vaksinat, serumet mjekësore, diagnostikuesit, shtamet dhe përbërësit (ingredientët) për prodhimin e tyre. Ato prodhohen nga institucionet e autorizuara nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe përdoren pasi të jenë kontrolluar nga laboratorit i kontrollit veterinar shtetëror që varet nga Drejtoria e Shërbimit Veterinar. Biopreparatet regjistrohen në librin shtetëror që mbahet në Drejtorinë e Shërbimit Veterinar.

Neni 88

Importimi, eksportimi dhe shitja e biopreparateve, medikamenteve dhe prodhimeve biologjike për kafshë, bëhet vetëm me licencë të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar, pasi më parë të jetë kryer kontrolli laboratorik në laboratorin e kontrollit shtetëror veterinar dhe të jenë regjistruar në librin shtetëror që mbahet në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 89

Ngritja e qendrave të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të biopreparateve, medikamenteve dhe prodhimeve biologjike bëhet pasi të jetë marrë leja e Ministrisë së Bujqësisë dhe e Ushqimit.

KREU IV INSPEKTORATI VETERINAR

Neni 90

Për kontrollin e zbatimit të ligjit për shërbimin veterinar ngrihet Inspektorati Veterinar Shtetëror që organizohet brenda sistemit të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit në Drejtorinë e Shërbimit Veterinar dhe shtrihet në organet e veterinarisë në rreth, në zyrën veterinare në bashki dhe në zyrën veterinare në komunë.

Neni 91

Detyrën e Inspektorit veterinar e kryejnë vetëm persona të diplomuar mjekë veterinerë dhe të atestuar për këtë specialitet. Ngarkohet Fakulteti i Mjekësisë Veterinare për kualifikimin e mjekëve veterinerë si inspektorë.

Neni 92

Inspektorati veterinar ushtron kontrollin e tij:

1. në tregjet e bagëtive.
 2. në industrinë ushqimore e përpunuese për përdorim nga njerëzit ose për ushqimin e kafshëve.
 3. në zbatimin e ligjshmërisë për profilaksinë veterinare dhe të masave për gjurmimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive e parazitare në zonat urbane dhe rurale.
 4. në mbrojtjen e kafshëve.
- Për shkeljet e konstatuara për rastet e mësipërme merr masa sipas dispozitave ligjore.

KREU V
INSTITUTI I KËRKIMEVE VETERINARE DHE LABORATORI VETERINAR NË RRETHE

Neni 93

Për zhvillimin e punës diagnostikuese dhe profilaktike veterinare në shkallë kombëtare funksionon Instituti i Kërkimeve Veterinare në vartësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Ai ka për detyrë të kryejë punë kërkimore-shkencore me shpenzime që përballohen nga shteti.

Neni 94

Objekti i Institutit të Kërkimeve Veterinare është kontrolli i gjendjes epizootike, prodhimi i biopreparateve e produkteve tjera biologjike e faramaceutike veterinare, diagnostikimi i sëmundjeve e përcaktimi i skemave për luftimin e sëmundjeve infektive e parazitare në shkallë kombëtare dhe kontrolli i produkteve e nënprodukteve ushqimore me origjinë nga kafshët të prodhuara në vend, si dhe ato që importohen ose eksportohen.

Neni 95

Instituti i Kërkimeve Veterinare lidhet me organizatat ndërkombëtare për të përcaktuar normat kombëtare të kontrollit të prodhimeve ushqimore me origjinë nga kafshët që përdoren për konsum nga kafshët dhe njerëzit. Për këta të fundit bashkëpunon me Institutin e Higjienës dhe Epidemiologjisë.

Instituti i Kërkimeve Veterinare është e vetmja qendër e referencës veterinare në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 96

Në vartësi teknike e metodike të Institutit të Kërkimeve Veterinare janë laboratorët veterinarë të rretheve dhe laboratorët e industrisë ushqimore që kryejnë analiza veterinare.

Neni 97

Laboratorët në rrethe organizohen në vartësi të shërbimeve veterinare të rretheve me qëllim kryesor diagnostik. Ata plotësojnë të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara për nevojat veterinare të rretheve.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 98

Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 10, 11, 13, 14, 15, 16, 18, 19, 23, 26, 27, 29, 33, 34, si dhe 75, 76, 77, 78, 79 dhe 80, kur nuk formojnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë nga 1000 deri në 5000 lekë nga veterinerët e zonës, të komunës, bashkisë, të rrethit dhe të Drejtorisë së Shërbimit Veterinar të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 99

Kafshët e gjalla, kur janë të sëmura dhe mbrijnë në pikën kufitare nga jashtë ose nga brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, konfiskohen.

Neni 100

Shkelja e rregullave të parashikuara në nenet 66, 68, 72, 75, 77, 78, 79, 80, 83 e 84, kur nuk formojnë vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë nga 5000 deri në 10000 lekë nga veterineri i Drejtorisë së Shërbimit Veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 101

Kundërvajtësit e dispozitave të neneve 81, 82 dhe 92 pika 4, dënohen me gjobë nga 100 deri në 1000 lekë, me mbylljen e veprimtarisë prodhuese ose me bllokimin e mjeteve të transportit e sekuestrimin e mallit.

Neni 102

Kundërvajtësit e neneve 87, 88 e 89 dënohen me gjobë deri në trefishin e vlerës së mallit dhe me sekuestrimin e tij ose mbylljen e veprimtarisë së qendrës prodhuese.

Neni 103

Kundër vendimit të dënimit, të parashikuar në nenet 98, 99, 100, 101 dhe 102, mund të bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes së vendimit ose e njoftimit të tij, përkatësisht te kryetari i komunës, bashkisë, rrethit ose te ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, vendimi i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 104

Kur shkeljet e parashikuara në nenet 98, 99, 100, 101 e 102 përbëjnë vepër penale, dënohen sipas Kodit Penal.

Neni 105

Ankimet e bëra kundër autoriteteve kompetente veterinare nuk mund të pengojnë ose të shtyjnë zbatimin e masave të marra në bazë të këtij ligji.

Neni 106

Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Ekonomisë dhe e Financave të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 107

Ligji nr.4625, datë 24.12.1969 "Për shërbimin veterinar", dekreti nr.7353, datë 13.1.1990 "Për Inspektoratin Veterinar", si dhe ato dispozita të akteve të tjera ligjore e nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 108

Ky ligj hyn në fuqi 30 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.479, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.